

REPUBLIKA E SHQIPERISE

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISE "I.S.C. Inovative System Construction" shpk

Në Tiranë, sot më datë 14.10.2022, shtetasit:

Arli Xhemalaj, shtetas shqiptarë, me nr Personal I40314054U madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte.

Arjan Sida, shtetas Shqiptar, me nr Personal I30927035E madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte.

shtetasit e mesiperm madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar, te cilet me cilesine e 'Ortakeve Themelues', kerkuan redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit ajo deklarone se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin Nr 9901, date 14.04.2008 'Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare', ne ligjin "Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimi "**I.S.C. Inovative System Construction**" shpk.

KREU I Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është: "**I.S.C. Inovative System Construction**" shpk.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria "**I.S.C. Inovative System Construction**" shpk, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (ketu e ne vijim referuar "Shoqëria"). Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tremeve për detyrimet dhe demet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Ajo do të ushtroje aktivitetin e saj në Republikën e Shqipërisë në baze të regjistrimit në institucionet tatimore dhe në regjistrat tregtar shqiptarë, si dhe jashtë saj në baze të modaliteteve ligjore që kerkohet nga shteti ku do të ushtroje veprimtarinë.

Shndërrimi i saj në një formë tjetër do të bëhet sipas dispozitave të këtij statuti dhe ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Për Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë kryesore në adresën : Tirane, Njësia Administrative Dajt, Qesarak, Rruga “Sotir Caci”, “Pallati Jon”, Shkalla 2, Ap.50

-Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është:

Projektim-zbatim-ndertim të objekteve civile, industriale, bujqësore, blektorale, ushtarake,turistike,kulturore,prodhime të ndryshme betoni armatura të ndryshme, punime restaurimi, rruge kanalizime, hidro sanitare, sisteme mbrojtjes kundër zjarrit, ujësjellës, objekte sociale kulturore ,objekte të tjera, si shkollat etj. Import eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjithë llojeve të mallrave industriale, bujqësore, blektorale, ushqimore, materialeve të ndertimit të perfunduara dhe të pa perfunduara, objekteve të ndertimit ,materialeve hidro sanitare, transport për vetë dhe për të tretet. Projektim – Zbatim. Punime germimi në tokë, ndertime civile dhe industriale, rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale veshje fasada, rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro,pista aeroportuale, punime nëntokësore, ura e vepra arti, diga e tunele hidroteknike, ujësjellës, gazesjellës, vajesjellës, vepra kullimi e vaditje, ndertime detare dhe punime thellimi në ujë, punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime, ndertimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike, ndertime për N/stacionet, kabinetet e transformatorëve, linjat e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. Import, export, shitje me shumicë dhe pakicë elektroshteshtepiake. Punime të inxhinierisë së mjedisit. Punime speciale ndertimi , Punime për prishjen e ndertimeve, impiante hidrosanitare, kuzhina, lavaxantë, mirëmbajtje e tyre, impiante ngritëse dhe transportuese (ashensore, shkallë levizëse, transportues), punime rifiniture me material druri, plastike, metalike dhe xhami, rifiniture të natyrës teknike ndertuese, impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut, sinjalistika rrugore jo ndriçuese ,barriera dhe mbrojtje rrugore, ndertime parafabrikat dhe beton armë, punime strukturore speciale, shtresa dhe mbistruktura speciale, punime mbi shina dhe traversa, impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit, impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, impiante të brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.Pastrimi i ujrave detare, liqenor dhe lumor, ndertimi i impianteve të ujit të pishem dhe pastrimi i tij. Punime topogjeodezike, shpime gjeologjiko-inxhinierike, puse e shpime për ujë. Grumbullim, transport dhe menaxhim dherash, mbetje inertesh dhe shtuf. Punime ndertimore, sinjalistike etj. për njëzërit me aftësi të kufizuar, të verbër, shikim të ulët etj. Sistemet kundër zhurmës për infrastrukture.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë dhe është i ndarë në 2 kuota, perkatesisht: **Arli Xhemalaj**, është zotëruesi i 1 kuote me vlere totale 50.000 lekë, e cila perfaqëson 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Arjan Sida, është zotëruesi i 1 kuote me vlerë totale 50.000 leke, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute ne shërbime.

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga organi kompetent i një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e percaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshëm marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale.

Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjetër.

Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, ç'do person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqesore prishjen e shoqërisë.

Kjo prishje nuk mund te shpallet, ne qofte se rregullimi eshte bere ne ditën kur gjykata mblidhet per te marre vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar. Projekti i transferimit i njoftohet shoqerise dhe secilit prej ortakeve.

Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit sipas paragrafit te mesiper, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene. Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, ortaket, brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi, duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar me vleren e percaktuar sipas rregullave te nenit 11 te ketij ligji.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleje e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakeve branda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore, te hartuara nga administratoret.

Vendimet merren pas konsultimit me shkrim te ortakeve, ne rast se ortaket miratojne me shkrim permbajtjen e konsultimit. Ortaket lajmerohen me leter rekomande te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese. Ne kete leter njoftohet rendi i dites. Lajmerimi behet nga administratori ose, ne mungese se ka te tille. Secili ortak mund te kerkoje ligjerisht caktimin e nje mandatmbajttesi te ngarkuar per thirrjen e asamblese dhe Cdo

Neni 10

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaket qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.



Neni 11

Administrimi

Administratori i shoqerise caktohet : Arli Xhemalaj, i datlindjes 14.03.1984 lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane i njohur me dokumentin e identifikimit karte identiteti I40314054U i cili do te ushtroje funksionet ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare.

Administratori emerohet dhe shkarkohet nga vendimi i asamblese se ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Pervec kesaj, administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.

Neni 12

Kompetencat

Shoqeria administrohet nga nje Administrator. Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratoret perfqesojne Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shtetore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, vec e vec ose se bashke, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Administratori ka te drejte qe te celi llogari bankare dhe te kryeje veprime prane bankave te te gjitha niveleve kudo ku shoqeria disponon llogari bankare.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te punesuar personelin e shoqerise duke respektuar dispozitat e Kodit te Punes.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i Administratoreit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet.

Administratori ose ortaket qe nuk jane persona juridike nuk u lejohet te kontraktujne ne cfaredolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezenes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshe e pavlefshme.

Neni 13

Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.



Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleje qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratororet dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratoreve, ortaket individualisht ose sebashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratoreve. Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkatuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.

Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratoreve per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratoret.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendeteve, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, sic edhe parashikohet nga ligji, ne raport me kuotat e zoteruara nga secili prej ortakeve.

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetore dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e Asamblese se Ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ia paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe kane.

Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim te ortakeve, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj,

duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante, krijimin e Rezerves Ligjore. Rezerva Ligjore krijohet vit pas viti nepermjet lenies menjane te nje shume te barabarte me 5% te fitimit neto te realizuar gjate secilit vit financiar, deri sa te arrihet nje shume e barabarte me 10% te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Neni 18

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve te shoqerise.

Neni 19

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar sic mund te jene:

- a) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te meteshem te veprimtarise se saj.
- b) Ne nje nga menytrat e parashikuar nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare".
- c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja

Shoqeria me ane te bashkimit, mund t'i kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo themelon.

Shoqeria gjithashtu me ane te ndarjes mund t'i kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ekzistuese ose disa shoqerive te reja.

Ortakët e shoqerise, qe bejne kalimin e trashegimise se saj ne kuadrin e operacioneve te permendura me lart perfitojne pjese te kapitalit themeltar nga shoqeria ose shoqerite perfituese dhe sipas rastit nje kompensim me para, vlera e te cilit nuk mund te kaloje 10 % te vleres nominale te pjeseve te kapitalit themeltar te dhena.

Operacionet e permendura me lart mund te realizohen ndermjet shoqerive te formave te nddryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa lukuidim te shoqerise qe zhduket, dhe kalimin e plote te trashegimise se saj te shoqerite perfituese, ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashegimi ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njekohesisht per ortakët e shoqerive qe zhduken marrjen e cilesise se ortakeve te shoqerive perfituese sipas kushteve te percaktuar ne kontraten e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21



Afati i miratimit te likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parshikon ligji perkates duke specifikuuar dhe dokunetat qe duhen depozituar ne QKB.

Neni 22

Lukuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtatasve te vecante apo personave fizike apo juridike vendas apo te huaj.

Neni 23

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne te kunderten ceshtja mund te behet objekt konflikti gjyqesor ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt-themelimi, statutin e saj dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Neni 25

Mosmarrveshjet

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij aktthemelimi, si dhe per cdo mosmarrveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.


Neni 26

Dispozita perfundimtare


Ky akt-themelimi u reduktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues te shoqerise tregtare "I.S.C. Inovative System Construction" shpk, dhe nenshkruset ne Tirane sot me date 14.10.2022.

Ortaket e shoqerise

Arli Xhemalaj



Arjan Sida



SHOQERIA "I.S.C. Inovative System Construction" shpk

